



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.127/13

Prishtinë, më 27.09.2013, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani Jelena Bontić, Latif Gashi Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi Xhevdet Neziri Sevdije Lama, Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Jurgen Schatz, Rejhane Zylfijaj Ramadan Islami nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dites

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 16.09.2013;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë nr.07/149 datë 19.09.2013 për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës në duhan;**
- 4. Caktimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, dt. 16.09.2013

Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Vendimin e Qeverisë nr.07/149 datë 19.09.2013 për ndryshimin e normës së tatimit të akcizës në duhan

Kryetarja theksoi se në pajtim me ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin e akcizës në Kosovë, Qeveria ka marrë vend për ndryshimin e normës së akcizës në duhan dhe ka kërkuar qendrimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Siç mund të kuptojmë nga përmbajtja e vendimit, kemi të bëjmë me rritjen e akcizës në duhan nga 27 euro për njësi në 30 euro për njësi, duke filluar nga 1 tetori 2013 dhe nga 30 euro për njësi në 32 euro për njësi duke filluar nga 1 janari 2014. Ministria e Financave pas analizave të bëra ka vlersuar se rritja e akcizës në duhan do të kontribuojë në shëndetit të qytetarëve, do të ndikojë në gjenerimin e hyrjeve shtesë buxhetore, dhe nuk do të ndikojë negativisht në evazionin fiskal. Po ashtu në bazë të analizave të politikës fiskale dhe krahasimeve të vendeve të regjionit të atyre të BE-së lidhur me normat e akcizës, ministria thekson se në vendet e regjionit dhe të BE-së kanë ngarkesa më të larta fiskale se republika Kosovës.

Besim Beqaj njoftoi se ideja për rritjen e normës së akcizës në duhan ka ardhur nga takimi që është mbajtur me herët në nivel të ministrave të financave të rajonit në Mal të Zi. Në Kosovë, norma e akcizës në duhan është norma më e ultë në rajon duke i përfshi të gjitha taksat që e asociojnë shitjen e cigarës, sepse në disa shtete kanë dhe taksa tjera. Sa i përket ndikimeve në buxhet do të jenë pozitive, por do të ketë ndikim edhe në implementimin e ligjit për duhanit. Ky vendim nuk do të krijoj hapësirë për evazion fiskal, por do të kontribuojë në eliminimin e evazionit fiskal. Norma është rritur me kujdes në mënyrë që mos të ndikon në qmime në pakicë dhe presim që kjo mos të bartet nga qytetarët por nga prodhuesit e duhanit. Normat nuk janë të larta dhe nuk ka arsyeje për rritje qimimesh, pasi që që edhe rritja është paraparë në dy faza. Kjo është trajtuar edhe në bisedat me FMN edhe me Bankën Botërore.

Sali Asllanaj unë parimisht rritjen e akcizës së duhanit jam pro, por kisha pas dëshirë dhe propozim që krahas rritjes të akcizës së duhanit, qeveria të bëjë subvencionimin e produkteve të konsumit të gjërë ushqimore, të shportës konsumuese të qytetarëve. Sa i përket ngarkesave tatimore për duhanin dhe alokholin, do ta kenë gjithëmonë përkrhajnë time, por duhet të ketë arsye edhe politikat tatimore që ndikojnë direkt në standardin e qytetarëve dhe shtresën e varfër. Kishte me qenë shumë e justifikueshme dhe e pranueshme për qytetarët nëse një pjesë e mjeteve nga akciza, shkojnë për ndonjë produkt kundër kancerit apo kundër sëmundjeve të ndryshme të cilat kanë lidhje me efekte negative të duhanit.

Naser Osmani është fjala për një produkt i cili nuk është jetësorë dhe pa të cilin jetohej edhe dhe më shëndetshëm jetohej. Inkurajimin ma shton edhe respektimi i ndalesës së pirjes së duhanit. Nga përvoja në shtetet evropiane kam parë që akciza në duhan është e lartë dhe qëllimi është që të ndikohet aq sa është e mundur në pirjen e duhanit. Ne po themi se kjo rritje duhet të reflektoj te prodhuesi dhe jo te konsumuesi, dhe unë mendoj që kjo ka mu shpërnda të të gjithë nga pak edhe në fund ka me qenë aq i pavërejtur si çmim dhe aq i parëndësishëm por për buxhetin e Kosovës do të jetë një hyrje e konsiderueshme. Personalisht e përkrhajnë këtë propozim.

Hykmete Bajrami duhe u ndërlidhur me ndikimin e rritjes së akcizës në qmime, unë e di që është ekonomi e tregut dhe është e pa mundshme me i kontrollue qmimet, por jamë e sigurtë që këtu ka me ndikue në qmimin final të produktit. Ne kemi pas rastin para ca vitesh kur e kemi rrit TVSH prej 15% në 16% dhe kemi pa se gjithë tregtarët e kanë pritur me gëzim dhe i kanë rritur çmimet e tyre ndoshta në normën minimale në 20%. Zakonisht Qeveria kur propozonë ngritje të taksave gjithmonë

bëjnë krahasime me vendet e rajonit, por kur flitet për pensionet, pagën mesatare apo pagën minimale, justifikohemi se kemi një buxhet të vogël, një bazë më të ulët zhvillimore etj., do të thotë jemi pak me parimorë kur vijnë me propozime të tilla edhe kur jemi përball kërkesave të tilla. Përndryshe ngritjen e akcizës në duhan e përkrahim.

Besim Beqaj sa i përket subvencionimit, dua të ju them se qeveria e ka marrë një vendim për heqjen e TVSH-së për produkte bujqësore primare, duke i përfshirë këtu dhe frutat dhe perimet e prodhimet e qumshutit. Sa i përket destinimeve të mejteve, ne nuk mundemi të bëjmë asnjë takse e cila do ta ketë destinimin e vetë, por do t'ju them se ne në vitin 2014 do të ketë refleksione buxhetore në drejtim të shëndetësisë, agrobiznesit dhe arsimit. Sa i përket orientimit të kontributeve, buxheti i republikës së Kosovës është i orientuar në 40% në investime kapitale që në asnjë shtet nuk e kemi, ndërkajë subvencionet dhe transferet që përfshijnë beneficione për kategori të ndryshme përbën shfren më të lartë në rajon. Këto janë faktet të cilat mundet të themi se është një shpërndarje shumë e kujdesshme dhe shumë e favorshme nga buxheti i republikës së Kosovës.

Kryetarja atë që ka thënë z. Salihu që përkundër lirimeve në produktet bujqësore, ndoshta ai ka aloduar më shumë në shkallëzimin e TVSH-së dhe është mirë që ministria me e pas analizë në këtë drejtim sepse kjo është diskutuar me vite të tëra po ende nuk kemi arritur në këtë nivel për të hyrë në këtë shkallëzimin e tillë të normave të TVSH-së dhe duhet ta keni parasysh për ma tutje

Pas diskutimeve, Komisionit njëzëri nxorri këtë

P e r f u n d i m

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu Propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin e normës së akcizës në duhan, në Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.
4. **Caktimi i Grupit Punues për shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-102**

Kryetarja propozoi që të formohet grupi punues prej 5 anëtarësh dhe pjesë e grupit të jenë: Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama.

Propozimi u përkrah njëzëri.

4. Të ndryshme

4.1. Kryetarja e kemi caktuar dy grupe punuese për monitorimin e ligjit. Është grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik që zgjatur mjaft puna dhe grupi punues për lojërat e fatit që sa kanë filluar punën dhe shpresojë se do të përshejtohet puna në mënyrë më intensive e grupeve dhe të përfudohet puna.

Naser Osmani sa i përket ligjit për lojërat e fatit, si kryesues i grupit punues, njoftoj se sot kemi arritur me e përmbyllë idenë. Kemi angazhuar një ekspert financiar që ka qenë punëtor i Administratës Tatimore dhe sot punon si auditor në një kompani ndërkombëtare, dhe përveq analizës

paraparke të zbatimit të ligjit, e kemi angazhu me bë një hulumtim në dogana, është fjala për importin dhe akcizen për automatet, në administratë tatimore me i marr të gjitha të dhënat sa paguhet tatim dhe dhe a po ka perpuethshmëri në mes sasisë që hyn në dogana dhe tatimet që paguhet në ATK dhe kemi vendos me shku me i vizitu 3 vende ku kemi informata që ka koncentrim të madh të lojrave të fatit, është fjala për një lagje në Prizren, në Ferizaj edhe në Prishtinë. Do të bëjmë në mënyrë të dokumentuar, me fotografi të dhënat lidhur me zbatimin apo jo të ligjit. Po ashtu sot e kemi angazhuar një psikologje e cila ka me bë një raport për ndikimin e lojrave të fatit në familje, me problemet sociale që lindin prej këtyre lojrave të fatit. Meqenëse psikologja do të paguhet prej buxhetit të Komisionit, sipas rregullave ligjore, kërkohet që Komisioni paraprakisht të merr një vendim për angazhimin e saj në punë.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin për angazhimin e Gyltene Dërguti në cilësinë e ekspertes (psikologje) në procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Lojërat e Fatit,

Latif Gashi njoftoi se grupi punues për monitorimin e ligjit për prokurimin publik është në përfundim të punës dhe shumë shpejt do të përfundojë punën.

4.2. Kryetarja njoftoi se Zyra e Kryeministri, respektivisht grupi punues që udhëheq procesin e plotësimit-ndryshimit të Ligjit për Prokurimin Publik, ka dërguar një shkresë që shpreh gatishmërinë për organizimin e një punëtorie të përbashkët me Komisionin për Buxhet dhe Financa nga dt. 6-9 tetor 2013 në Shqipëri, për të diskutuar lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e grupit punues të Komisionit gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, në mënyrë që të kihet parasysh gjatë propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Organizimin dhe financimin e vizitës ka shprehur gatishmëri ta mbështes GIZ. Të gjithë anëtarët e Komisionit që kanë interes me marrë pjesë në vizitë, duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre më së largu të hënën në zyret e stafit që mbështesin komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj